



KUVENDI KOMUNAL
GJAKOVË

MUNICIPLITY OF
GJAKOVA

ZYRA KADASTRALE—GJEODEZI—PRONË

faqe-1

Për: Kryetarin Dr. Pal Lekaj.

Lënda: Programi i punës për vitin 2012.
Hyrje.

Fushë veprimtaria e Drejtorisë

Drejtoria Komunale për Kadastër – Gjeodezi dhe Komasaçion, vepron në bazë të Ligjit mbi KADASTRIN-RDPP (Nr.2003/25, LIGJI MBI KADASTRIN NR.04\L-013 DT.29 KORRIK 2011, Ligjin mbi Hipoteka si dhe Udhëzimeve Administrative të aplikueshme në këtë lëmi, gjë që duke u zbatuar me përpikshmëri, kanë bërë të mundur, që kërkesat e parashtruar pranë Drejtorisë të gjejnë mbështetje në parimin, **”Funksionimi i mirë i të drejtës së tregut të patundshmërisë dhe tokës duke e përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Komunën e Gjakovës”**.

Bazuar në këto Ligje Drejtoria do të mbështesë këto parime themelore të Programit të Punës në fusha të kompetencës të saj si:

- Zbatimi i Ligjit dhe Administratimi i Drejtë kadastral
- Avancimi dhe Zhvillimi Kadastral Digjital
- Rilevime gjeodezike të tokës me objekte dhe infrastrukturë, (Kadastrin Nëntokësorë).
- Komasaçioni i tokës Bujqësorë
- Konsultimin e Ligjit dhe aftësimin e personelit kadastral si:
 1. Në programet e RDPP-së sistemin Manual dhe Digjital si dhe
 2. Në programin Gjeomedia-trajnime në vazhdimësi.

2. PROGRAMI I PUNËS për V.2012—faqe.2.

I. Administrimi kadastral-në periodën e ardhshme do të ketë mbështetje në faktorin vendor dhe të realizohet me kërkesat kohore e në mbështetje të financimit real dhe programor të komunës sonë.

-Bashkëpunimi me të gjitha Drejtoritë dhe Gjykatën Komunale

Duke i paraqitur gjithnjë kërkesat në formën e shkruar me kohë pranë kësaj Drejtorie, e të cilat i mundësojnë që kërkesat e drejtorive të kryhen me kohë sasi dhe cilësi, sipas Dinamikës dhe planëprogramit të paraparë.

Vazhdimi i shqyrtimit të kërkesave për uzurpime në Tokën Komunale.

- Zona kadastrale Gjakovë Jashtë Qytetit

Gjegjësisht potesi "Carpotok-Rruga Tirana-Lumi Llukac gjer në bashkim me Limin Erenik ". Afati i kryerjes së punimeve 60 ditë pune (15prill-15 Qershor).

- Zona Kadastrale Rogovë- I .

Gjegjësisht Zona Urbane sheshet, rrugët nga veriu në jug.
Afati i kryerjes punimeve 30 ditë pune (01 korrik -30 Korrik).
Dy ekspert gjeodezik, dy Jurist. Sigurimi i ortofotove për këtë pjesë të terrenit nga AKK.

- Zona Kadastrale Korenicë.

Gjegjësisht sheshi i fshatit.
Dy Ekspert gjeodezik, dy jurist.
Afati i kryerjes së punimeve 15 ditë pune (Gusht-Shtator), Sigurimi i Ortofotove për këtë pjesë të terrenit nga AKK.

-Zona Kadastrale Jahoc.

Gjegjësisht potesi Dardani ish Piskota
Dy Ekspert gjeodezik , dy Jurist
Afati i kryerjes së punimeve 40 ditë pune (shtator-Nëntor)

Sigurimi i rilevimit të gjendjes faktike (60ha)në potezin Carapotok-Gj.J.Q. nga Drejtoria për Urbanizëm.

Gjatë procedurës do të konstatohen shpenzimet e nevojshme për kryerjen e këtyre punimeve, andaj duhet të bëhet kompensimi për bashkëpunëtor që kryerjen punimet profesionale, në formë të avancuar nga Buxheti Komunal nga të hyrat e Shërbimeve Kadastrale ,ndërsa këto mjete të shpenzuara për Ekspertet e lartcekur bashkë me krijimin e kësaj të hyre buxhetore si pozicion i Ri do ti kthehen Buxhetit Komunal.

II. Zhvillimi Kadastral në periodën e ardhshme do të ketë synim të përpunimit dhe kontrollimit të shënimeve grafike të digjitalizuar duke i krahasuar dhe përpunuar sipas prioriteteve të përcaktuara nga drejtoritë relevante komunale si dhe harmonizimin e shënimeve të reja Aerofotogrametrie të V. 2001.

-Regjistrimi i pasurive të paluajtshme dhe të drejtave në to (Tokat e ndërtesat) në bazë të Ligjit mbi Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së paluajtshme,(RDPP).

-Drejtoria do të jetë e gatshme që të bëjë regjistrimin në RDPP të të Drejtës së shfrytëzuesve të Pronës Komunale në bazë të aktit Juridik nga Organi kompetent Komunal duke filluar nga viti 2005.

-Regjistrimi i Hipotekave në bazë të Ligjit mbi Hipotekat.

-Regjistri i Kadastrit të Përvojave Nëntokësore .

-Regjistrimi i Kadastrit Etazhitetit-Banesave.

-Kalimi në sistemin e Ri-Koordinativ-Kosova-REF.01
Në bazë të konkluzionit nga AKK datë 15.04.2006.

III. Rilevimi gjeodezik i tokës me objekt dhe infrastrukturë

1. Në periodën e ardhshme Drejtoria do ti kryej shërbimet përkatëse të gjitha Drejtorive të Komunës, si dhe palëve të interesuara për shërbime gjegjëse drejtpërdrejtë apo nëpërmjet Gjykatave, por gjithnjë duke i paraqitur kërkesat e tyre në formën e shkruar dhe ato **pesë (5) ditë** pune përpara, në mënyrë që Drejtoria e Kadastrës ,Gjeodezisë dhe Pronë, ti Koordinoi terminët në mënyrë që këto kërkesa të kryhen me kohë sipas dinamikës së plan programit të paraparë.

OBJEKTIVI I DREJTORISË PËR V.2012 JANË SI :

Pajisja e Drejtorisë me Shënime Digjitale të Aerofotografimit të v.2004 të instaluar në CD për të gjithë territorin e Komunës së Gjakovës, si edhe me instrumente profesionale bashkëkohore Gjeodezike si:

1. Pajisja me shënime digjitale kadastrale në CD. Borxhi për tu paguar i këtij materiali AKK-së është:

1. Ortofotot Rurale 423 fajlla digjitale , në vlerë prej. 7402.50. Euro.

2. Ortofotot Urbane 324 fajlla digjitale ,në vlerë pre. 9072.00. Euro.

Gjithsej = 16.474.50.Euro.

1. Totali Stacion 1200 Leica me programe kompjuterike cca 12 000. Euro

2. GPS 503 (Global Posicion System) Leica 3 baza 48-52.000. Euro

3. Trajnim profesional në sistemin LIS-GIS. (shkon me pajisje).**Këto pajisje i kemi kërkuar dhe gjatë viteve por gjerë më tani end nuk janë realizuar.**

PROGRAMI PRESPEKTIV I PËRFUNDIMIT TË TËRSISHËM TË TRI FAZAVE TË KOMASACIONIT NË KOMUNËN E GJAKOVËS

Për përfundimin e suksesshëm të dy fazave të komasacionit në Komunën e Gjakovës, propozojmë programin për përfundimin e punimeve tekniko-gjeodezike për tokat e rregulluara me komasacion të Fazës së Parë-I. Dhe të Fazës së dytë-II. Sipas skemës tabelore si:

PASQYRA TABELARE E EFEKTIT NË KOMASACION FAZA I

Nr	Nr i Pjesëmarrëseve	Nr. pjesë marrësve	Siper .e komas	Posedi shoqëror e	Posedi Privat	Nr. Parcel.para komasacion	Nr.parc. Pas Komasaç	Numri Ankesave	Vërejtje
1.	Janosh	97	224ha	55 ha	169 ha	565	140	5	
2.	Trakaniq	75	254ha	110 ha	144 ha	351	80	4	
3.	Osek Pashë	55	114ha	3 ha	111 ha	340	84	5	
4.	Qerim	87	380ha	118 ha	262 ha	680	180	4	
5.	Bec I	15	271ha	205 ha	66 ha	199	29	0	
6.	Novosell Ulët	30	58 ha	5 ha	53 ha	134	32	5	
7.	Gjakovë J.Q	60	1.400 ha	1.300 ha	100 ha	2.280	152	0	
8.	Ujz	93	354 ha	100 ha	254 ha	747	148	5	
9.	Rogovë I	209	478 ha	340 ha	138 ha	608	260	10	
10	Rogovë II	200	206 ha	26 ha	180 ha	693	260	4	
11	Marmull	120	356 ha	185 ha	171 ha	354	190	5	
12	Doblibare I	87	187 ha	11 ha	176 ha	361	132	10	
13	Bërdosanë	294	544 ha	330 ha	214 ha	952	409	3	
	Gjithësejtë në Fazën e I.	1.422	4.826 ha	2.788 ha	2.038 ha	8.264	2.096	60	

FAZA II

14	Bec II		1000 ha	606.22.11	393.78		
15	Doblibare II	163	600 ha	339.10.90	266.89.10	648	262
16	Meqe	41	350 ha	175.01.68	174.98.32	292	105
17	Vraniqi	114	200 ha	173.39.08	226.60.92	416	200
18	Cermjan-F.shRakovin		200 ha				
	Gjithësejtë në Fazën e III.		2550 ha				

REKAPITULLIMI

18	Gjithësejtë në të dy(2) fazat	1740	7.376.00 ha						
----	-------------------------------	------	-------------	--	--	--	--	--	--

Propozim: Duke u bazuar në konfiguracionin e terenit në Z.K. Cermjan, në të cilin teren është i pa mundur zbatimi i Komasicionit në fshatin Cermjan nga tabelori janë paraqitur vetëm 200 ha në fshatin Rakovinë ku edhe është kryer Komasicioni.

Përpunimi i Imazheve të Aerofotografimit.

-Përgatitja për bashkëpunim në kërkesat e përditshme ,si të Institucioneve dhe të vetë qytetarëve të Komunës tonë.

Rikonstruimi i Regjistrimit të Etazhitetit (Banesat) dhe plotësimi në programin Kompjuterik ,Mikrosoft .Excel ku do të krijohen të hyra të reja buxhetore Komunale për 2.300-2.500 banesave.

Hartimi i Kadastrit-përvojave-sipas kërkesave të palëve të interesuara me qenë se do të filloj marrja e Lejeve të përdorimit të Objekte Ekonomike të cilat e kanë për obligim rilevimin e objekteve dhe përvojave nëntokësore.

-Realizimi do të jetë në perioden tri-katër vjeçare- si rezultat i bashkëinvestimit me KEK.PTK, Hidrosistemi “Radoniq”. Ngrohja e qytetit dhe pronar të përvojave nëntokësore proporcionalisht nga gjatësia e tyre, ku do të krijoheshin të hyra të reja buxhetore Komunale.

Elaborati kadastral i marrur nga Serbia- do të inkorporohet në formë valide sipas prioriteteve në qoftëse kthehet si:

-Gjendja Kadastrale 1994-1999, Objekt “Gjakova Qytetit 82”, si dhe objekti “ Gjakova 86”, pjesa Jashtë masës së Komasicionit.

Plotësimi i Rrjetit Gjeodezik Transformimi në Kosovaref 01 dhe harmonizimi me Agjensin Kadastrale të Kosovës sipas “ Teramodel” me GIS-LIS.

Në Fund

Programi i Punës do të realizohet me kompletimin e sistemit të parapar me sistematizimin e stafit punues të Drejtorisë bashkë me pajisje e mjeteve themelore të parapara në këtë program, si dhe sigurimin e mjeteve financiare për përfundimin e të dy fazave të tokave në masën e komasicionit të përfshira në 18 Zona Kadastrale si sipërfaqe e 7.376.00 ha në Komunën e Gjakovës.

Ky program ka filluar gjatë vitit 2008-2009 dhe pjesët e përfunduara do të përcillen në vitin 2012 , si vazhdimësi në kontinuitet kohor e gjithnjë bazuar nga

donacionet , respektivisht sigurimi i mjeteve financiare , si nga buxheti Komunal po ashtu edhe nga buxheti i Qeverisë të Kosovës.

01.03.2012

Drejtori

Xhevat Rraci. Jur i dipl.